



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Ministria e Financave

# Raporti fiskal mujor

*Janar - Shtator 2011*

**Tetor, 2011**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>Treguesit Fiskalë Kryesorë për periudhën Janar-Shtator 2011.....</b>	<b>2</b>
<b>Analiza e të ardhurave për periudhën Janar -Shtator 2011.....</b>	<b>2</b>
<b>Vështrim i përgjithshëm.....</b>	<b>2</b>
Taksimi direkt .....	8
<b>Analiza e shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2011 .....</b>	<b>12</b>
<b>Vështrim i përgjithshëm.....</b>	<b>12</b>
<b>Shpenzimet korrente.....</b>	<b>13</b>
Shpenzimet e personelit.....	13
Shpenzimet për interesa .....	14
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes .....	14
Shpenzimet për subvensione .....	15
Shpenzimet për fonde speciale .....	15
Shpenzimet të pushtetit lokal .....	16
Pagesa e papunësisë.....	16
<b>Shpenzimet kapitale.....</b>	<b>17</b>

**TREGUESIT FISKALË KRYESORË PËR PERIUdhËN JANAR - SHTATOR 2011**

Nga të dhënat e Thesarit të Ministrisë së Financave, për nëntëmujorin e vitit 2011 të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 239.3 miliardë lekë (shih tabelen 1). Të ardhurat totale buxhetore ishin 2.5 përqind më të ulëta së parashikimi dhe 1.1 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet totale arritën në 270 miliardë lekë (shih tabelën 1), 2.8 përqind më të ulëta së planifikimi dhe 3.5 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet korrente janë rritur mbi baza vjetore me 3.7 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale janë ulur me 4.4 përqind.

Defiçiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në këtë tetë-mujor në 30.7 miliardë lekë, 1.7 miliardë lekë më pak se planifikimi, dhe 6.5 miliardë më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Defiçiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brëndshme (kryesisht huamarrje): 348 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e defiçitit; 30.2 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brëndshme neto. Financimi i huaj neto i defiçitit ka qenë në nivelin 10.1 miliardë lekë, ose 752 milionë më shume se planifikimi.

Tabela 1. Treguesit kryesorë të buxhetit të konsoliduar për periudhen Janar-Shtator

Miliardë lekë	Janar - Gusht '10	Janar - Gusht '11	Planifikimi 2011
TE ARDHURAT TOTALE	236.7	239.3	245.5
SHPENZIMET TOTALE	260.9	269.9	277.8
Nga të cilat: SHPENZIMET KORRENTE	216.1	224.6	224.6
Nga të cilat: SHPENZIMET KAPITALE	47.9	50.3	50.2
BALANCA FISKALE	- 24.2	-32.4	-32.4
BALANCA PRIMARE	+ 5.9	-1.9	-1.7

**ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUdhËN JANAR - SHTATOR 2011****Vështrim i përgjithshëm**

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 9-mujore arritën në 239.3 miliardë lekë, 2.5 përqind më pak se parashikimi në buxhetin e rishikuar për vitin 2011 dhe 1.1 përqind më shumë se një vit më parë duke shënuar rritjen më të ulët në pesë vitet e fundit.

EMERTIMI	9M-2007	9M-2008	9M-2009	9M-2010	9M-2011
TOTALI TE ARDHURAVE (mln lekë)	181,931	208,924	220,820	236,693	239,257
Rritja vjetore	12.1	14.8	5.7	7.2	1.1

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u realizuan në masën 97.1 përqind ndaj parashikimit, ose rreth 169 miliardë lekë nga afersisht 174 miliardë lekë të planifikuara, dhe 2.7 përqind më shumë se 9-mujori i një viti më parë; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 9.2 miliardë lekë nga 10.5 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar të vitit 2011 dhe me rritje vjetore prej 5.9 përqind; të ardhurat në fondet speciale arritën 41.6 miliardë lekë, nga rreth 42.1 miliardë lekë të planifikuara, dhe kundrejt 39.3 miliardë të një viti më parë, me rritje vjetore 5.8

përqind; të ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën 1.8 miliardë lekë nga rreth 2.3 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat jo-tatimore kanë qenë për këtë periudhe 17.5 miliardë lekë nga 21.7 miliardë të një viti më parë, me rënie vjetore -19.6 përqind dhe realizim të planit të rishikuar prej 117.7 përqind.

Pesha specifike e çdo tatimi në Totalin e të Ardhurave Tatimore

	E M E R T I M I	09 – MUJORI	
		STRUKTURA	
		2010	2011
<b>II.</b>	<b>TE ARDHURAT TATIMORE GJITHSEJ</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>
<b>II.1</b>	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>77.4%</b>	<b>76.9%</b>
1	T.V.SH.	39.7%	38.5%
2	Akciza	6.1%	6.9%
3	Tatimi mbi Fitimin	13.5%	13.2%
4	Ardhura Personale	9.4%	9.3%
5	Taksat Nacionale dhe të tjera	6.4%	6.6%
6	Taksa Doganore	2.4%	2.3%
<b>II.2</b>	<b>Të ardhurat nga Pushteti Vendor</b>	<b>4.1%</b>	<b>4.2%</b>
<b>II.3</b>	<b>Të ardhurat nga Fondet Speciale</b>	<b>18.5%</b>	<b>18.9%</b>

Sipas agjencive të mbledhjes, administrata doganore ka mbledhur 90.6 miliardë lekë, - 0.6 përqind më pak se parashikimi në buxhetin e rishikuar për 2011, dhe me rritje 3.8 përqind kundrejt 9-mujorit të parë të vitit 2010. Sipas zërave të të ardhurave që mbledhin doganat, bie në sy performanca e rentës minerare në eksport, që është rritur mbi baza vjetore me rreth 59.2 përqind, kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve të burimeve natyrore, si dhe ndryshimeve në normën e taksimit dhe në strukturën e taksës gjatë gjysmës së parë të vitit 2010. Të ardhurat nga akciza në doganë rezultojnë me rënie prej -6.8 përqind, kundrejt një viti më parë. Të ardhurat nga TVSH-ja në import janë 6 përqind më të larta se një vit më parë dhe 1.3 përqind më shumë se parashikimi për periudhën sipas buxhetit të rishikuar.

## Të ardhurat në Dogana sipas muajve dhe krahasimi me 2010

Dogana total 2011	Muaji (miliardë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010
Janar	8.1	-34.3	13.4
Shkurt	8.2	1.3	9.9
Mars	9.5	16.2	-3.4
Prill	9.4	-1.3	-3.6
Maj	9.9	5.7	-4.8
Qershor	11.1	12.3	8
Korrik	11	-1.4	2.3
Gusht	13.3	21.3	17.6
Shtator	10.1	-23.8	-2.3

Administrata tatimore ka mbledhur 3 përqind më shumë të ardhura se 9-mujori i vitit 2010, ose 3.5 miliardë lekë më shumë (përfshirë dhe kontributet) për një total prej 116.6 miliardë. Totali i të ardhurave tatimore ka pasur një rritje prej 1.5 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa të ardhurat nga kontributet janë rritur me 6.3 përqind mbi baza vjetore. Administrata tatimore ka rezultate të mira në mbledhjen e tatim fitimit, akcizës dhe taksave nacionale për këtë periudhë krahasuar me një vit më parë, ndërsa TVSH-ja ka pasur një rënie prej -15.3 % në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

## Të ardhurat në Tatime sipas muajve dhe krahasimi me 2010 (pa kontributet)

Tatime total 2011	Muaji (miliardë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010
Janar	9.0	-2.8	7.0
Shkurt	7.8	-13.9	8.4
Mars	10.7	37.6	17.0
Prill	7.7	-28.0	-4.1
Maj	9.2	19.4	15.8
Qershor	8	-12.4	-2.6
Korrik	8.7	7.9	-1.2
Gusht	8.4	-3.4	-11.9
Shtator	9	6.9	-10.3

## Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera

## Taksimi i konsumit (indirekt)

Nga TVSH-ja janë mbledhur gjithsej për 9-mujorin 84.7 miliardë lekë, ose 0.5 përqind më shumë se një vit më parë dhe -1 përqind më pak se parashikimi në buxhetin e rishikuar për vitin 2011.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar në vite për 9-mujorin

<b>EMERTIMI</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Total (milionë lekë)	77,998	81,200	84,345	84,725
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Total (në %)		4.1	3.8	0.04
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Dogana (milionë lekë)	54,263	56,272	62,276	66,010
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Dogana %		3.7	10.6	5.9
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Tatime (milionë lekë)	23,735	24,928	22,068	18,713
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Tatime %		5	-12	-15.2

**Nga Administrata Doganore** janë mbledhur 66 miliardë lekë TVSH mbi mallrat e importuar, duke realizuar planin e periudhës në masën 101.3 përqind. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 78 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë të jenë 3.75 miliardë lekë më shumë, ose 6 përqind më shumë. Për muajin Shtator TVSH-ja në doganë ka një mosrealizim prej 220 milionë lekë, ose 3 përqind.

Të ardhurat nga TVSH-ja në doganë ndikohen direkt nga vlera e importeve (volumet e importuara, çmimet në import dhe kursi i këmbimit). Për periudhën 9- mujore vlera e importeve sipas të dhënave të DPD është rritur mbi baza vjetore me 13.8 përqind kundrejt 2010. Kapitujt kryesorë të mallrave me kontribut pozitiv në rritjen e importeve ishin: drithërat, lëndet djegëse minerale, disa metale bazë (si giza dhe çeliku), makineri dhe pajisje mekanike dhe mjete transporti. Të dhënat e Doganave tregojnë rënie të importeve të produkteve si: fruta dhe zarzavate, duhani dhe nënproduktet, disa lloj materialesh ndërtimi, etj. Sasia e zhdoganuar e karburanteve ka një ulje drastike krahasuar me muajin Gusht (shih tabelën më poshtë), megjithatë në vlerë importet e grupit “lëndë djegëse dhe minerale” kanë një rritje vjetore për periudhën Janar - Shtator prej 41.4 përqind.

Në importin e makinerive dhe pajisjeve, kemi për periudhën Janar - Shtator shtyrje të TVSH-së në nivelin 2.6 miliardë lekë, nga 2 miliardë të së njëjtës periudhë të vitit 2010.

Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat mbi vlerën e importit për 9-mujorin të makineri-pajisje për vitet 2007 - 2011, për të cilat aplikohet shtyrja e TVSH-së në import për një vit, ose më shumë si dhe vlera e TVSH së shtyrë.

Kapitulli	2007	2008	2009	2010	2011
84 (makineri, pajisje) (mln lekë)	22,573	25,555	29,186	23,434	30,528
85 (makineri, pajisje) (mln lekë)	14,877	20,772	23,205	25,760	26,783
87 (mjete transporti) (mln lekë)	18,300	18,568	19,893	17,546	17,742
<b>Total</b> (mln lekë)	55,750	64,895	72,284	66,740	75,052
<b>Total importi</b> (mln lekë)	543,958	632,699	314,613	349,654	397,875
Makineri pajisje ne % ndaj totalit	10	10	23	19	19
<b>TVSH e shtyre (mln leke)</b>		1,467	2,003	2,048	2,563

**Nga administrata tatimore** për periudhën Janar - Shtator janë mbledhur 18.7 miliardë lekë TVSH, nga 20.5 miliardë lekë të planifikuara sipas buxhetit të rishikuar 2011, që do të thotë 8.5 përqind më pak se parashikimi dhe 15.3 përqind më pak se një vit më parë. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 22 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja.

Rimbursimi i TVSH-së për periudhën 9-mujore ka arritur shifrën 5 miliardë lekë, nga 4.3 miliardë që ishte një vit më parë, me rritje 16.9 përqind, siç pasqyrohet në tabelën në vijim.

Milionë lekë	2010	2011	Në % ndaj 2010
TVSH e arketuar (bruto)	88.6	89.7	1.2
TVSH neto	84.3	84.7	0.4
Rimbursimi faktik i paguar	4.3	5	16.9

Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 22 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Në strukturën e të ardhurave tatimore që mbledhin tatimet, vihet re rënia e peshës specifike të TVSH-së ndaj totalit, nga 29 përqind në 9-mujorin 2010, në 24 përqind për 9-mujorin 2011.

Sipas sektoreve kryesore të ekonomisë situata paraqitet në tabelën në vijim.

Emertimi	9 mujor 2010 (mln lekë)	9 mujor 2011 (mln lekë)	Ndryshimi në %	Subjekte pagues 2010	Subjekte pagues 2011	Ndr shim i ne %
<b>Prodhim</b>	5,440,138	5,867,060	7.8%	1,291	1,288	-0.2%
<b>Ndërtim</b>	6,174,463	3,916,063	-36.6%	1,583	1,809	14.3%
<b>Transport</b>	308,449	338,504	9.7%	317	305	-3.8%
<b>Tregti</b>	3,079,679	3,133,279	1.7%	3,441	3,602	4.7%
<b>Shërbime</b>	7,105,128	5,468,767	-23.0%	2,537	3,757	48.1%

## Akciza

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën Janar - Shtator arritën në rreth 29.1 miliardë lekë; ose -3.7 % me pak se parashikimi sipas planit në buxhetin e rishikuar; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010, të ardhurat nga kjo taksë janë rritur në masën 1.7 përqind. Akciza pësoi ndryshime të ndjeshme në Qershor të vitit 2010, ku: shënoi ulje akciza mbi kafën e papjekur (nga 70 lekë, në 30 lekë/kg), u hoqën nga lista e mallrave me akcizë lëngjet e frutave dhe pijet freskuese, në grupin e nënprodukteve të naftës shtohet artikulli “naftë virgin” me nivel akcize 50 lekë/litër; u shtuan në listën e mallrave me akcizë: fishekzjarret, gomat, pilat dhe bateritë primare, ambalazhet; ndryshoi taksimi i llampave inkandeshente nga ad valorem në shumë fikse. Në fillim të vitit 2011 pati rritje të akcizës mbi cigaren, nga 50 lekë, në 70 lekë/paketë. Ndërsa ndryshimi më i fundit lidhet me ndryshimin e akcizës për disa mallra si birra, solar mazut dhe koks naftë.

Të ardhurat nga akciza që mbledhin Doganat ka një rënie me 6.8 përqind kundrejt një viti më parë dhe 5 përqind më pak se parashikimi për periudhën. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe të birrës së importuar, si dhe të mallrave të tjera që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës (siç janë mallrat që i janë shtuar listës së mallrave të akcizës). Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata e zhdoganimeve për periudhën ka qënë si vijon:

- Sasia e karburanteve të zhdoganuara për periudhën Janar - Shtator 2011 është 309.3 mijë ton, me rënie vjetore 14.6 përqind. Siç e thamë dhe më lart periudha e fundit u karakterizua nga një import i pazakonte i karburanteve gjatë muajit Gusht (rreth 74 mijë ton) dhe kthim në nivele të ulëta gjatë muajit Shtator (rreth 24 mijë ton) si pasojë e reagimit të subjekteve importuese ndaj vendosjes së taksës së qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin, e hyrë në fuqi në fund të Gushtit, duke krijuar rezerva.
- Sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën Janar – Shtator 2011 është 2,262 ton, me rënie vjetore prej -26 përqind. Rënia e importeve të cigares për këtë vit është shkaktuar pjesërisht nga shtimi i importeve në muajt e fundit të 2010, para hyrjes në fuqi të rritjes së akcizës.
- Sasia e birrës së zhdoganuar për periudhën Janar – Shtator 2011 është 25.3 milionë litra, me një rënie prej 12.1 përqind
- Kafeja e zhdoganuar për periudhën 9-mujore ka qënë 10.9 përqind më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Të dhënat e zhdoganimeve të mallrave të forta për periudhën 9-mujore në disa vite pasqyrohen në tabelën më poshtë.

EMERTIMI	9 mujour 2008	9 mujour 2009	9 mujour 2010	9 mujour 2011
<b>Karburantet (ton)</b>	308,223	335,410	362,326	309,277
Ndryshimi në %	2.02%	8.82%	8.02%	-14.64%
<b>Birrë (000 litra)</b>	27,310	29,708	28,847	25,338
Ndryshimi në %	8.97%	8.78%	-2.90%	-12.17%
<b>Cigare (ton)</b>	3,040	3,279	3,056	2,262
Ndryshimi në %	17.94%	7.85%	-6.80%	-25.96%
<b>Kafe (ton)</b>	4,550	5,050	4,428	4,915
Ndryshimi në %	1.59%	11.00%	-12.31%	10.99%



Nga administrata tatimore janë mbledhur nga akciza rreth 12.1 miliardë lekë, me rritje vjetore 16.8 përqind dhe realizim të planit të rishikuar në masën 98.2 përqind. Tatimet mbledhin akcizën mbi cigaret dhe pijet alkolike përveç birrës, përmes pullës së akcizës, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vënd (ARMO). Në tabelën në vijim pasqyrohen të dhënat e të ardhurave nga akciza në vite për 9-mujorin dhe sipas agjencive të mbledhjes (doganë/tatime).

Të ardhurat nga akciza për 9-mujorin 2008 - 2011

	9-mujor 2008	9-mujor 2009	9-mujor 2010	9-mujor 2011
<b>Akciza gjithsej (mld lekë)</b>	<b>24.9</b>	<b>25.9</b>	<b>28.6</b>	<b>29.1</b>
<b>Ndryshimi vjetor %</b>	<b>19.62%</b>	<b>4.28%</b>	<b>10.38%</b>	<b>1.72%</b>
Doganë	15.4	15.3	18.3	17
Tatime	9.5	10.6	10.3	12.1

### Taksimi direkt

#### Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 20.5 miliardë lekë për periudhën Janar - Shtator, me rritje 2.9 përqind në krahasim me 9-mujorin e një viti më parë dhe me realizim të planit të rishikuar për vitin 2011 në masën 96.9 përqind. Sipas komponentëve të këtij tatimi, situata e të ardhurave të mbledhura këtë vit dhe krahasimi me 2010 jepet në tabelën më poshtë.

Të ardhura, miliardë lekë	9-mujor 2010	9-mujor 2011	Ndryshimi %
<b>Tatimi mbi të ardhurat personale gjithsej</b>	<b>19.9</b>	<b>20.5</b>	<b>+2.9</b>
Paga sektori publik	6.2	6.6	+6.5
Paga sektori jo-publik	6	6.6	+9.7
Interesa	2.3	2.5	+5.1
Dividendë	1.24	1.26	+1.5
Shitje pasuri e paluajtshme	1.8	1.1	-37.3
Të tjera	2.36	2.44	3.3

Përveç tatimit mbi shitjen e pasurive të paluajtshme, të gjitha zërat e TAP kanë ecuri shumë pozitive të të ardhurave krahasuar me një vit më parë, veçanërisht zëri i tatimit mbi pagën, që mbi baza vjetore është rritur me 8 përqind, çka tregon rritje të indikatorit “ëage bill”, që ndikohet nga niveli i punësit dhe niveli i pagave.

Në këtë aspekt performancën më të mirë e ka patur sektori prodhues, pasuar nga sektori i shërbimeve (përsa i takon sektorit privat). Subjektet e sektorit privat që kanë deklaruar dhe paguar (në burim) TAP për 9-mujorin e këtij viti janë 25,204 krahasuar me 23,909 të periudhës 9-mujore të një viti më parë.

**Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi**

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 9-mujorin 2011 arritën në rreth 15.3 miliardë lekë nga 13 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rritje të ndjeshme prej 16.9 përqind, dhe në linjë me planin e rishikuar.

Tatim fitimi 2011	Muaji (milionë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010
Janar	1,302	-22.5	23.9
Shkurt	1,113	-14.5	-10.1
Mars	3,973	+257	38.9
Prill	1,319	-66.8	10.0
Maj	2,289	+73.5	104.1
Qershor	1,316	-42.5	13.0
Korrik	1,237	-6.0	10.2
Gusht	1,413	14.2	-26
Shtator	1,314	-7	-5.8

Në rezultatin e të ardhurave për tatim fitimin për këtë vit ka ndikuar derdhja e tatim fitimit nga KESH në muajin Maj për bilancin e vitit 2010, në shifrën 1,147 milionë lekë. Edhe për sektorin privat, kemi një rezultat mjaft të mirë krahasuar me vitin e kaluar. Arkëtimet e muajit Mars gjatë të cilit bëhen derdhjet e tatim fitimit bazuar në bilancet për vitin parardhës, për vitin 2011 janë rreth 39 përqind më të larta se marsi i vitit 2010. Situata rezulton më e mirë në sektorin publik të prodhimit, ku përfshihet pikërisht elektro-energjitika (KESH-i) dhe sektori i karburanteve (Albpetrol, me pagesë tatim fitimi 110 milionë lekë).

Rritjen më të madhe në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë e ka shënuar sektori i prodhimit me 61.2 %, pasuar nga sektori i tregtisë dhe shërbimeve, me përkatësisht 21 % dhe 11.9 %.

Sipas sektorëve kryesore të ekonomisë - situata paraqitet në tabelën në vijim.

Emërtimi	9 mujor 2010 (mln lekë)	9 mujor 2011 (mln lekë)	Ndryshimi në %	Subjekte pagues 2010	Subjekte pagues 2011	Ndryshimi në %
Prodhim	2,692,027	4,340,405	61.2%	1,911	1,798	-5.9%
Ndërtim	2,766,105	2,277,136	-17.7%	1,935	1,826	-5.6%
Transport	346,066	296,809	-14.2%	438	441	0.7%
Tregti	2,540,306	3,072,921	21.0%	5,147	4,829	-6.2%
Shërbime	4,727,640	5,291,740	11.9%	1,762	1,854	5.2%

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël arritën në 2.24 miliardë lekë, me rritje vjetore prej 23.9 përqind duke arritur 56.4 përqind më shumë se parashikimi sipas buxhetit të rishikuar. Këtu theksojmë se shifra 2.24 miliardë lekë nuk përfshin edhe vlerën e taksës që nuk

është mbledhur për rimbursimin e çmimit të kasave. Kjo vlerë rimbursimi arrin në rreth 465 milionë lekë, të përbulluara nga fondi i kontingjencës së parashkuar në buxhetin e vitit 2011.

### **Taksimi i pasurisë**

Për qellime analize, këtu përfshijmë tatimin mbi ndërtesat, mbi tokën bujqësore dhe taksën e kalimit të pasurisë së paluajtshme. Është prej kohësh një pjesë problematike e sistemit tatimor, përse i takon të ardhurave të mbledhura kundrejt të ardhurave potenciale që mund të mblidhen nga pasuria e paluajtshme. Administrimi dhe grumbullimi i taksës mbi pasurinë rezulton të jetë përgjithësisht efektiv përse i përket bizneseve dhe institucioneve/ organizatave dhe ndjek të njëjtën tendencë në arritjen e nivelit të parashkuar të të ardhurave me taksat dhe tarifatat e tjera të aplikueshme nga njesitë vendore (tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit). Ndërkohë, eksperiencia nuk është e njëjtë për kategorinë "Familjarë" të taksapaguesve. Këtu tendenca në grumbullimin e kësaj takse është e ulët, dhe njesitë e qeverisjes vendore kanë mjaft probleme në administrim dhe në detyrimin për pagimin e taksës. Për nivelin ende të lartë të informalitetit, ka mjaft vështirësi në vlerësimin e bazës së taksueshme, për arsye të mangësive në deklarimin real të pasurive. Për 9-mujorin taksat mbi pasurinë arrijnë në 1.5 miliardë lekë nga 2.1 miliardë të parashkuara dhe 4.8 përqind më të ulëta se një vit më parë

### **Taksat nacionale**

Të ardhurat nga taksat nacionale në total për periudhën, janë 14.5 miliardë lekë nga 15.9 miliardë lekë të parashkuara për periudhën Janar - Shtator. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash ka pësuar një rritje prej 7.2 përqind. Muaji shtator ishte muaji i parë i zbatimit të taksave të reja të hyra në fuqi në fund të gushtit. Ende nuk kemi të dhëna të detajuara për të ardhurat e mbledhura nga këto zëra për muajin shtator

### **Taksa doganore**

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën Janar - Shtator janë rreth 5.1 miliardë lekë, -7.5 përqind më pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010, të ardhurat nga kjo takse janë ulur me 120 milionë lekë, ose -2.3 përqind. Niveli mesatar i taksës doganore për këtë periudhë është 1.59 përqind nga 1.74 përqind në vitin 2010, duke kontribuar kështu dhe në uljen e të ardhurave nga taksat doganore.

### **Të ardhura të tjera nga pushteti vendor**

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën Janar - Shtator arritën në 9.2 miliardë lekë nga 10.5 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin 2011, ndërsa kundrejt 9-mujorit të parë të vitit 2010 të ardhurat janë rritur me 512 milionë lekë (rreth 5.9 përqind). Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogël dhe taksat mbi pasurinë për të cilat folëm më lart) kanë mbledhur rreth 5.4 miliardë lekë nga 6.9 miliardë të parashkuara, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë me vitin e kaluar këto taksa kanë pësuar një rritje të lehtë 2.9 përqind.

### **Të ardhurat e fondeve speciale**

Të ardhurat në fondet speciale për periudhën Janar - Shtator 2011 arritën në 41.6 miliardë lekë, me një rritje prej 5.8 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë dhe -1.3 përqind më pak se parashikimi sipas buxhetit të rishikuar. Ky grup të ardhurash përbën rreth 19 përqind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, 40.3 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 1.2 miliardë lekë të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 35.8 miliardë lekë, me rritje vjetore 8.4 përqind; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 4.6 miliardë lekë, -6.1 përqind më pak se 9-mujori i një viti më parë.


Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 9-mujore rezulton se: në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektori shtetëror dhe sektori privat) prej 8.01 përqind, ose rreth 30.9 mije njësi, kundrejt mesatares 9-mujore të 2010 nga ku sektori i tregtisë dhe shërbimeve zënë pjesën kryesore përkatësisht me rritje 20.18% dhe 7.12%. Në tabelat më poshtë pasqyrohen të dhënat lidhur me numrin mesatar mujor progresiv të kontribuesve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për pjesën që administron administrata tatimore dhe ndarjen e të ardhurave nga kontributet që mbledhin tatimet sipas sektorëve të ekonomisë.

	<b>09-mujor 2010</b>	<b>09-mujor 2011</b>	<b>Ndryshimi në %</b>
<b>Ndërmarrjet Buxhetore</b>	131,911	138,054	4.66%
<b>Ndërmarrjet Shtetërore</b>	21,680	22,025	1.59%
<b>Subjektet Private T.V.SH.</b>	167,873	180,907	7.76%
<b>Subjektet Biznesit Vogël</b>	63,796	75,139	17.78%
<b>Total</b>	<b>385,259</b>	<b>416,124</b>	<b>7.9%</b>

**ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN JANAR – SHTATOR 2011****Vështrim i përgjithshëm**

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të muajit shtator 2011, arritën në rreth 270 miliardë lekë, nga rreth 278 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 97.1 përqind të parashikimit të periudhës ose me një mosrealizim prej rreth 8.0 miliardë lekë. Krahasuar me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në rreth 69.1 përqind, ndërsa kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 9.9 miliardë lekë më shumë ose rreth 3.8 përqind më të larta. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në shumë absolute, ritmi i rritjes së tyre gjatë periudhës janar-shtator, në disa vite, si dhe ritmi linear i rritjes, jepet në grafikun e mëposhtëm:

Shpenzimet e përgjithshme Janar - Shtator në vite:



Shpenzimet e përgjithshme sipas elementëve kryesore përbërës të tyre, realizuar gjatë periudhës janar-shtator 2000-2011, në milionë lekë, jepen në tabelën e mëposhtme:

**SHPENZIMET 9 MUJORE NE VITE***ne milion leke*

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>116,355</b>	<b>127,967</b>	<b>129,187</b>	<b>139,939</b>	<b>151,330</b>	<b>161,795</b>	<b>152,236</b>	<b>171,725</b>	<b>220,169</b>	<b>269,863</b>	<b>260,132</b>	<b>269,991</b>
<b>I. Shpenzime Korrente</b>	<b>95,163</b>	<b>99,560</b>	<b>108,076</b>	<b>119,788</b>	<b>130,328</b>	<b>138,951</b>	<b>137,310</b>	<b>146,622</b>	<b>169,564</b>	<b>199,253</b>	<b>216,589</b>	<b>223,887</b>
1 Personeli	23,353	28,785	28,910	30,816	34,409	38,125	39,492	40,090	46,344	45,441	47,770	49,511
2 Interesat	24,396	18,147	18,011	22,477	23,071	20,576	19,438	18,405	23,019	25,630	30,054	28,838
3 Shpenzime Operative Mirembajtje	11,826	10,830	13,986	15,436	16,280	16,744	13,410	15,097	16,624	20,637	23,257	24,150
4 Subveconet	2,735	4,975	5,243	2,843	3,224	2,564	1,725	1,766	1,506	1,541	3,151	2,970
5 Shpenzime per Sig. Sociale	22,708	26,110	29,151	32,402	36,616	40,600	43,433	50,581	55,423	70,635	77,489	83,471
6 Buxheti lokal	3,925	4,473	6,752	9,863	10,149	12,941	12,615	12,508	17,196	23,615	21,666	20,758
7 Shpenzime te tjera	6,220	6,240	6,023	5,951	6,579	7,401	7,197	8,175	9,452	11,243	13,202	14,189
<b>II. Shpenzime Kapitalle</b>	<b>20,444</b>	<b>26,965</b>	<b>21,111</b>	<b>20,151</b>	<b>21,002</b>	<b>22,844</b>	<b>14,926</b>	<b>21,353</b>	<b>45,450</b>	<b>70,525</b>	<b>46,759</b>	<b>46,104</b>
1 Financimi Brendshem	11,054	14,836	10,532	11,669	13,928	15,447	11,233	15,821	19,376	57,694	35,167	31,937
2 Financimi Huaj	9,102	12,129	10,579	8,482	7,074	7,397	3,693	5,532	26,074	12,831	11,592	13,967


Në analizën e shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2011 duhet mbajtur parasysh fakti se në realizimin faktik të tyre, janë përfshirë edhe shpenzimet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe nga fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit.

- Fondi rezerve i Këshillit të Ministrave, i planifikuar në rreth 1.93 miliardë leke për vitin 2011, deri në fund të muajit shtator është ekzekutuar në rreth 1.63 miliardë leke, përfshirë rreth 205.0 milionë leke për shpenzime për paga, rreth 737.0 milionë leke për shpenzime të tjera korente dhe rreth 692.8 milionë leke për investime.
- Fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit, i planifikuar në rreth 3.65 miliardë leke, deri në fund të muajit shtator është përdorur në rreth 1.42 miliardë leke në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimet, tek njesitë e qeverisjes vendore

### Shpenzimet Korrente

**Shpenzimet korente** në fund të muajit shtator 2011, kanë arritur në rreth 223.9 miliardë lekë ose rreth 99.8 përqind të parashikimit të periudhës, duke rezultuar me një diferencë prej rreth 545 milionë lekë. Krahasuar me planin vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 71.9 përqind, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 7.3 miliardë lekë më të larta ose rreth 3.4 përqind më shumë.


Shpenzimet korrente Janar - Shtator



### Shpenzimet e Personelit

Brenda shpenzimeve korente, shpenzimet e personelit, që përfaqësojnë rreth 22.1 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë periudhës janar-shtator 2011, rezultojnë rreth 0.9 përqind nën parashikimin e periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime në fund të muajit shtator janë realizuar në rreth 72 përqind të tij, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë shpenzimet e personelit rezultojnë rreth 1.7 miliardë lekë më të larta, ose rreth 3.6 përqind më shumë.

## Shpenzimet për personelin Janar - Shtator




Shpenzimet për paga janë në të njëjtën kohë rreth 3.6 përqind më të larta se një vit më parë ose rreth 1.5 miliardë lekë më shumë se një vit më parë, ndërkohë që shpenzimet për sigurimet shoqërore janë rreth 254 milionë lekë më shumë ose rreth 3.9 përqind më të larta, se një vit më parë. Keto dy grupe shpenzimesh janë realizuar pothuajse në nivelin e parashikimit të periudhës duke qenë në të njëjtën kohë respektivisht shpenzimet për paga rreth 72.9 përqind të planifikimit vjetor dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore në rreth 74.5 përqind të këtij planifikimi.

## Shpenzimet për Interesa

Shpenzimet për interesa që përfaqësojnë rreth 12.9 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë periudhës janar-shtator 2011, rezultojnë me një kursim prej rreth 1.9 miliardë lekë, rrjedhojë kjo e kursimit për rreth 1.5 miliardë lekë në interesat e brendshme dhe rreth 347 milionë lekë në interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor interesat janë realizuar në rreth 61.6 përqind, ndërsa krahasuar me një vit më parë ato rezultojnë rreth 1.2 miliardë lekë më të ulta ose rreth 4.0 përqind më pak. Ecuria e shpenzimeve për interesa gjatë periudhës janar-shtator, në vite jepet nga grafiku i mëposhtëm:


Shpenzimet për interesa Janar - Shtator:



## Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes gjatë periudhës janar-shtator 2011 arritën në rreth 24.2 miliardë lekë duke qënë rreth 2.4 miliardë lekë mbi nivelet e parashikuara. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 83.4 përqind të tij. Në të njëjtën kohë ato rezultojnë rreth 893 milionë lekë më të larta se një vit më parë ose rreth 3.8 përqind më të larta.


**Shpenzimet O&M periudha Janar - Shtator 2011:**



**Shpenzimet për Subvencione**

Shpenzimet për subvencione në fund të muajit shtator 2011 arritën në rreth 2.97 miliardë lekë ose rreth 1.49 miliardë lekë më shumë se parashikimi. Këtu duhet marrë parasysh edhe fakti i përmendur më sipër se rreth 1.42 miliardë lekë janë dhënë me vendime të Këshillit të Ministrave, në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, tek njësitë e qeverisjes vendore.

**Shpenzimet per Subvencione Janar – Shtator 2011**



**Shpenzimet për Fonde Speciale**


Shpenzimet për fonde speciale gjatë periudhës janar-shtator 2011 rezultojnë rreth 1.0 miliardë lekë më pak apo rreth 1.2 përqind nën nivelin e parashikimit të periudhës. Kundrejt planit vjetor shpenzimet për fondet speciale janë realizuar në nivelin 71.8 përqind, nga të cilat sigurimet shoqërore janë realizuar në rreth 73.9 përqind të planit vjetor, sigurimet shëndetësore në rreth 71.0 përqind dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve në rreth 53.2 përqind të këtij plani.

Krahasuar me një vit më parë shpenzimet për sigurimet shoqërore rezultojnë rreth 4.7 miliardë lekë më të larta ose rreth 8.0 përqind më shumë, ndërsa shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë rreth 1.4 miliardë lekë më të larta, ose rreth 7.9 përqind më shumë.

Shpenzimet per kompensimin e pronareve ne fund te muajit shtator 2011 rezultojne rreth 372 milione leke nen parashikimin e periudhes duke qene ne te njejten kohe rreth 29 perqind nen kete parashikim. Krahasuar me nje vit me pare keto shpenzime rezultojne rreth 13 perqind me te ulta




## Shpenzimet per Sigurimet Sociale Janar – Shtator 2011



## Shpenzime të Pushtetit Lokal

Shpenzimet e pushtetit vendor zënë rreth 9.3 përqind të shpenzimeve korrente. Për periudhën janar- shtator 2011 ato kanë arritur në rreth 20.8 miliardë lekë nga rreth 21.7 miliardë lekë të planifikuara për këtë periudhë të vitit 2011, duke rezultuar me një mosrealizim per rreth 910 milionë lekë ose rreth 4.2 përqind nen parashikimin e periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime kanë arritur në rreth 70.8 përqind të tij. Krahasuar me një vit më parë këto shpenzime rezultojne rreth 908 milionë lekë më të ulta ose rreth 4.2 përqind më pak. Ecuria e shpenzimeve të pushtetit vendor për periudhen janar-shtator për disa vite jepet nga grafiku i mëposhtëm.

Shpenzimet për pushtetin lokal Janar - Shtator:




## Pagesa e Papunësisë

Pagesa e papunësisë është realizuar në rreth 90.9 përqind të parashikimit të periudhës, duke qënë rreth 59.7 përqind e parashikimit vjetor dhe në të njëjtën kohë rreth 153 milionë lekë më pak se viti i kaluar ose rreth 19.6 përqind më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ndihma ekonomike gjatë periudhës janar-shtator 2011 rezulton rreth 51 milionë lekë më shume ose rreth 0.4 përqind mbi parashikimin e periudhës, duke qënë në të njëjtën kohë rreth 72.1 përqind e planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë ndihma ekonomike rezulton rreth 240 milione leke me shume ose rreth 2 perqind me shume.

Shpenzimet për mbrojtjen sociale Janar - Shtator 2011:




Shpenzimet Kapitale

Shpenzimet kapitale deri në fund të muajit shtator 2011 janë realizuar në nivelin e 91.4 përqind të parashikimit të periudhës ose në rreth 62.5 përqind të planit vjetor. Këtu duhet të mbahet parasysh se rreth 692.8 milionë lekë janë dhënë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për investime. Brenda këtyre shpenzimeve, investimet me financim të brendshëm janë realizuar në masën 77.9 përqind, ndërkohë që investimet me financim të huaj janë realizuar në masën 42.9 përqind të parashikimit vjetor.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar investimet e brendëshme rezultojnë rreth 3.2 miliardë lekë më të ulta ose rreth 9.2 përqind më pak, ndërkohë që investimet me financim të huaj rezultojnë rreth 2.4 miliardë lekë më të larta ose rreth 20.5 përqind më shumë. Për rrjedhojë, investimet në total në fund të muajit shtator 2011 janë rreth 1.4 përqind më të ulta ose rreth 0.7 miliardë lekë më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Shpenzimet kapitale Janar - Shtator 2011:



Struktura e investimeve kapitale të realizuar gjatë periudhës janar-shtator 2011 është rreth 69.3 përqind nga financimi i brendëshëm dhe rreth 30.3 përqind nga financimi i huaj. Diferenca është fondi për shpronësime.